



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.515/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.08.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Luar Bros” shpk nga procedura e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*” me Nr. REF-24623-05-30-2019, me objekt : “*Blerje tuba dhe materiale të ndryshme për Bordin e Kullimit*” me fond limit 1 332 173 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 10.06.2019 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Përmet.

Ankimues: “Luar Bros” shpk
Bulevardi “Gjergj Fishta”, Qendra Alpas, Kati2 Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Përmet
Sheshi “Abdyl Frashëri” Përmet

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e*

rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjeve, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 30.05.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*” me Nr. REF-24623-05-30-2019, me objekt : “*Blerje tuba dhe materiale të ndryshme për Bordin e Kullimit*” me fond limit 1 332 173 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 10.06.2019 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Përmet.

II.2. Në datën 10.06.2019 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 14.06.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

- Poçi-2004	901,250	I kualifikuar
- Sofia Myftari	1,230,880	I skualifikuar
- Alpha Solution Group	1,170,100	I skualifikuar
- Ligus	1,143,759	I skualifikuar
- Luar Bros	1,144,822	I skualifikuar
- Mifeel	1,090,290	I skualifikuar
- Paera	1,261,200	I skualifikuar
- Rosi	3,124,900	I skualifikuar

II.4. Në datën 14.06.2019 operatori ekonomik “Luar Bros” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për ofertën e tij në sistemin (SEP) për këtë procedurë prokurimi, për ofertën e operatorit “Luar Bros” shpk, rezulton se ky operator ekonomik nuk plotëson kriteret e vecanta të kualifikimit. Formulari i ofertës së operatorit ekonomik “Luar Bros” shpk nuk është hedhur në përputhje me preventivin e kërkuar nga AK Bashkia Permet. Në këtë preventivë është parashikuar që operatorët ekonomik të kryejnë furnizim vendosje të tubave të kerkuara. Pavarësisht se kemi të bëjmë me një procedurë blerje mallrash AK ka kërkuar që përveç furnizimit me mallrat të kryhet dhe procesi i vendosjes së këtyre mallrave.

Në ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimet Publike” i ndryshuar nën 3 “Perkufizime” “Kontrata publike furnizimi” janë kontratat publike, që kanë objekt blerjen, blerjen me pjesë ose me këste, qiranë me ose pa mundësi blerjeje të mallrave. Një kontratë publike, që ka objekt furnizimin me mallra dhe që përfshin në mënyrë dytësore edhe vendosjen dhe instalimin, vlerësohet si “kontratë publike furnizimi”, nëse vlera e mallrave e tejkalon vlerën e vendosjes apo instalimit. Në kuptim të perkufizimit që ben ligji për prokurimet publike kemi të bëjmë me një procedurë blerje mallrash kur vlera e mallrave që do të furnizohet e tejkalon vlerën e vendosjes së tyre si në rastin konkret. Elementi i parë që kerkohet për këtë procedurë është furnizimi me mallra dhe të lidhur me këtë do të jete dhe procesi i vendosjes së tyre sipas kërkesave të AK Bashkia Permet. Nga shqyrtimi i dokumentave të operatorit ekonomik “Luar Bros” vërehet se në formularin e ofertës operatori ekonomik mer përveshje veten furnizimin me mallra dhe jo dhe procesin e vendosjes së tyre sic kerkohet në dokumentat e tenderit. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Ndërsa në nenin 53 pika 3, të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.” Kriteret për kualifikim vendosen që t’i

shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Eshtë detyrim i operatorit ekonomik "Luar Brous" shpk që ta përgatisi ofertën në përputhje me kriteret e vendosura nga AK Bashkia Permet. Në këto kushte kjo ofertë do të skualifikohet.

II.5. Në datën 19.06.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- Sqarojmë se në asnjë rresht të DST apo në specifikimet teknike AK nuk ka kërkuar që oferta të jetë në përputhje me preventivin . Madje edhe shtojca përkatëse nuk është plotësuar. Më datë 14.06.2019 jemi njoftuar se oferta jonë është refuzuar për arsye se formulari i ofertës sonë nuk është hedhur në përputhje me preventivin e kërkuar nga AK. Ndërkohë oferta e renditur e para është pranuar në kundërshtim me LPP.
- Në datën 10.06.2019 dhe orën e përcaktuar në DST AK nuk ishte grumbulluar për të pritur ofertuesit. Në afatet ligjore vetëm subjekti ynë ishte paraqitur bashkë me mostrat ndërkohë që nuk ishte afuar asnjë përfaqësues apo OE tjetër. Kjo vërtetohet nëpërmjet akt konstatimit nr.05 prot të nënshkruar po në datën 10.06.2019 pra në AK Bashkia Permet. Pra askush tjetër nuk u paraqit për dorëzimin e mostrave dhe që automatikisht i vendos konkurentët e tjerë në statusin OE të skualifikuar. Pra rezulton se AK ka mbjtur procesverbal për dorëzimin e mostrës tonë si procesverbal individual ndërkohë duhet të kishte konfirmuar faktin e paraqitjes apo mosparaqitjes së OE të tjerë.
- Për më tepër që OE e renditur e para është anomalisht e ulët dhe AK ka pasur detyrimin të kërkojë sqarime përse kjo ofertë është në përputhje me DST. Kërkojmë që të skualifikohet OE i renditur i pari.
- Në lidhje me skualifikimin e ofertës sonë ne kemi ofertuar në përputhje me preventivin dhe kriteret e përcaktuara në DST. Në shtojcën 10 që lidhet me sasinë, AK ka referuar preventivin (indirekt). Pra qartazi AK ka përdorur preventivin si shkak të paligjshëm për të skualifikuar OE konkurent për të favorizuarit e tyre. AK nuk mund të kërkojë ofertë punimesh në një kontratë mallrash pasaktësuar se si do të jetë oferta. Sakëtësimi bëhet me qartësim dhe jo me deduksion. AK pohon që ka kontratë mallrash nga njëra anë, por nga ana tjetër kërkon që oferta të bëhet si për kontrata pune publike. AK nuk ka asnjë tagër të vlerësojë për një kontratë mallrash se oferta e dorëzuar nga OE është marrë në konsideratë ose jo kryerja e shërbimeve që lidhen me to. Ato janë aktivitete që lidhen me zbatimin e kontratës. Ne si OE kemi dorëzuar

ofertën në përputhje me specifikimet teknike të ngarkuara në shtojcën 9 dhe me sasinë e parashikuar në faqen preventive. AK ka dalë me një konkluzion që ne nuk e kemi deklaruar se nuk marrim përsipër kryerjen e shërbimeve që lidhen me to. Ne si OE kemi dorëzuar shtojcën 6 që merr përsipër të gjitha detyrimet e kontratës së propozuar, ndërkohë që në specifikimet teknike nuk ka asnjë referencë për shërbimet që lidhen me to për tu paraqitur si pjesë përbërëse e ofertës.

Sa më sipër kërkojmë kualifikimin e ofertës sonë dhe skualifikimin e ofertës të renditur e para si ofertë e kualifikuar pa të drejtë.

II.6. Me shkresën nr. 1408/2 prot datë 24.06.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke vendosur mospranimin e ankesës.

II.7. Në datën 02.07.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.1748 prot datë 09.07.2019 protokolluar me tonën me nr.1181/2 prot datë 11.07.2019 me objekt “*Dërgohet informacioni*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Luar Bros” shpk mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “*Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për ofertën e tij në sistemin (SEP) për këtë procedurë prokurimi, për ofertën e operatorit “Luar Bros” shpk, rezulton se ky operator ekonomik nuk plotëson kriteret e vecanta të kualifikimit. Formulari i ofertes së operatorit ekonomik “Luar Bros” shpk nuk është hedhur në përputhje me preventivin e kërkuar nga AK Bashkia Permet. Në këtë preventive është parashikuar që operatorët ekonomik të kryejnë furnizim vendosje të tubave të kerkuara. Pavarësisht se kemi të bëjmë me një procedurë blerje mallrash AK ka kërkuar që përveç furnizimit me mallrat të kryhet dhe procesi i vendosjes së këtyre mallrave”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Në shtojcën 1 “Formulari i ofertës” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si vijon:

Shtojca 1

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit _____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

* * *

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

1	2	3	4	5	6
Nr	Përshkrimi i mallrave	Sasia	Çmimi Njësi	Çmimi Total	Afati
Çmimi Neto)					
TVSH (%)					

Çmimi Total

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar ne dokumentat e tenderit)

III.1.2. Në shtojcën 9 “Specifikimet teknike” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Nr.	Emertimi I MALLRAVE	Specifikimet teknike
1	Tuba plasmasi $\phi 32$ mm	standart material plastik
2	Tuba rekorderi PE d=50mm	standart material plastik
3	Tuba rekorderi PE ϕ 63 mm, Pn 6	standart material plastik
4	Tuba plastmasi ϕ 100 I brinjezuar	standart material plastik
5	Tuba rekorderi PE 80 Pn 8 f=160 mm I vjaskuar	standart material plastik
6	Tub pvc 200 mm i vjaskuar	standart material plastik
7	Tuba te brinjezuara HDPE d=315 mm	standart material plastik
8	Tuba b/a ϕ 1000 mm	standart material beton/arme

III.1.3. Në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton i hedhur edhe dokumenti i mëposhtëm me emërtimin tubacione plastike 2019.

Preventiv					
Objekti: Blerje tuba + materiale te ndryshme, Bordi Kullimit					
Nr.an	Proceset e punes	Njesi	Sasia	Cmimi	Vlera
480/5	F.V tub plastmasi ϕ 32 mm	ml	500.0		
2.491/e	F.V Tuba e rakorderi PE d=50mm, t = 3.7 mm, PN 10	ml	50.0		
an	F.v Tuba e rakorderi PE ϕ	ml	300.0		

	63 mm, Pn 6				
3.654	Furnizim, vendosje tuba plastmase ø 100 I brinjezuar	ml	420.0		
An 135	F.V Tuba e rakorderi PE80 Pn 8 f = 160mm I vjaskuar	ml	57.0		
2.523	Tub pvc Ø 200 mm I vjaskuar	ml	150.0		
3.An/1t	F V tuba te brinjezuar HDPE d=315 mm	ml	205.0		
2.558	F.V tuba b/a Ø 1000 mm	ml	10.0		
				Shuma	
				Tvsh	
				Totali	

III.1.4. Referuar sa më sipër rezulton se autoriteti kontraktor ka skualifikuar operatorin ekonomik me arsyetimin se ”Formulari i ofertes se operatorit ekonomik “Luar Bros” shpk nuk eshte hedhur ne perputhje me preventivin e kerkuar nga AK Bashkia Permet. Ne kete preventiv eshte parashikuar qe operatoret ekonimik te kryejne furnizim vendosje te tubave te kerkuara. Pavarsisht se kemi te bejme me nje procedure blerje mallrash AK ka kerkuar qe pervec furnizimit me mallrat te kryhet dhe procesi i vendosjes se ketyre mallrave.

III.1.5. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.6. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimes ”Luar Bros” ka dorëzuar formularin e ofertës nga ku rezulton se në seksionin 2 të saj përshkrimi i mallrave rezulton të jenë cituar vetëm emërtimi i mallit pa e

shoqëruar me elementët FV (furnizim/vendosje) sikundër është përshkruar në preventivin e sipërcituar pjesë e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk mund të pretendojë se preventivi i hedhur në sistemin e prokurimeve elektronike nuk është pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit duke ju referuar vetëm dokumentave të tenderit e konkretisht shtojcës 1 formulari i ofertës dhe shtojcës 9 specifikimeve teknike dhe duke mos e marrë në konsideratë edhe dokumentin tjetër të hedhur regullisht në SPE në po të njëjtën datë, në formën e një preventivi i cili qartësisht tregon mënyrën e plotësimit të shtojcës 1 "Formulari i ofertës" me të gjithë elementët e nevojshëm pra dhe me zërat përkatëse FV të pajisjeve. Akoma më tej KPP gjykon se nga verifikimet në SPE ankimuesi është i vetmi operator i cili nuk ka plotësuar formularin e ofertës sipas modelit të preventivit të publikuar nga autoriteti kontraktor duke qenë kështu edhe i vetmi i cili nuk ka kuptuar funksionin e këtij dokumenti i cili duhet të përdorej si referencë për plotësimin e ofertës ekonomike. KPP gjykon se autoriteti kontraktor sipas përcaktimeve në preventiv përveç furnizimit të mallrave ka kërkuar edhe vendosjen e tyre një element i rëndësishëm që do të kryhet nga operatori ekonomik fitues. Me formularin e ofertës të paraqitur nga ankimuesi duket se nuk është marrë përsipër ky elementë e me të drejtë autoriteti kontraktor e ka konsideruar atë si mosplotësim në mënyrën e duhur të kësaj shtojce e rrjedhimisht ka vendosur skualifikimin e tij.

Në rastin konkret, K.P.P gjykon se ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës *onus probandi incubit actor* (barra e provës i bie kërkuarit). Operatori ekonomik ankimues për faktin e mosplotësimit të formularit të ofertës në mënyrën e duhur pretendon se ndodhemi përpara një kriteri të pakërkuar duke ju referuar vetëm shtojcave që janë pjesë e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi por anashkalojnë dhe nuk marrin në konsideratë të gjitha dokumentat e hedhura në SPE pasi edhe dokumenti i hedhur në SPE në formën e një preventivi është në vetvete modeli i cili duhet të referoheshin të gjithë operatorët sikundër ka ndodhur me pjesëmarrësit e tjerë në procedurë, për plotësimin e ofertës ekonomike, ndryshe nuk do të kishte asnjë funksion. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.7. Gjithashtu, Komisioni sqaron se nëse operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se "*Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të*

autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “ [...] *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]*”.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik të kualifikuar, KPP sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” i cili parashikon se: “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Luar Bros” shpk për procedurën e prokurimit, “*Kërkesë për Propozim*” me Nr. REF-24623-05-30-2019, me objekt : “*Blerje tuba dhe materiale të ndryshme për Bordin e Kullimit*” me fond limit 1 332 173 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 10.06.2019 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Përmet.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1181 Protokolli; Datë 02.07.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha